



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0135

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Kimete Gashi Brajshori duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) Eng Bau SH.P.K., kundër Njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit të KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Llot 1 Ndërtimi i urës metalike në fshatin Hallaq i Vogël, Llot 2 Rregullimi i kanalizimit në rrugën Aleksandër Stipcevic, Llot 3 Rikonstruimi i ndriçimit publik në Janjevë dhe Gadime e Ulët. me numër të prokurimit 613-24-10149-5-2-1, me 02.05.2025 mori:

Vendim

1. Aprovohet si pjeserisht e bazuar ankesa e OE Eng Bau SH.P.K. me nr. 2025/0135 , e datës 24.02.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit Llot 1 Ndërtimi i urës metalike në fshatin Hallaq i Vogël, Llot 2 Rregullimi i kanalizimit në rrugën Aleksandër Stipcevic, Llot 3 Rikonstruimi i ndriçimit publik në Janjevë dhe Gadime e Ulët. me numër të prokurimit 613-24-10149-5-2-1.
2. Mbetet ne fuqi B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK të KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN, ndërkaq aktiviteti i prokurimit Llot 1 Ndërtimi i urës metalike në fshatin Hallaq i Vogël, Llot 2 Rregullimi i kanalizimit në rrugën Aleksandër Stipcevic, Llot 3 Rikonstruimi i ndriçimit publik në Janjevë dhe Gadime e Ulët. me numër të prokurimit 613-24-10149-5-2-1
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
4. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik Eng Bau SH.P.K.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 27.09.2024 KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN, duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin për kontratë, për aktivitetin e prokurimit Llot 1 Ndërtimi i urës metalike në fshatin Hallaq i Vogël, Llot 2 Rregullimi i kanalizimit në rrugën Aleksandër Stipcevic, Llot 3 Rikonstruimi i ndriçimit publik në Janjevë dhe Gadime e Ulët. me numër të prokurimit 613-24-10149-5-2-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurën e hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: 35,000.00 euro.

Me 12.02.2025, AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, me të cilin ka shpërblyer me kontratë “Euro Raketa SH.P.K.” për aktivitetin e prokurimit.

Me 17.02.2025, OE Eng Bau SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim, e cila është refuzuar si e pa bazuar me Vendimin e AK të datës 20.02.2025.

Me 24.02.2025, OE Eng Bau SH.P.K., ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokoll 2025/0135, duke e atakuar Vendimin e cituar si më sipër të AK.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e Operatorit Ekonomik Eng Bau SH.P.K., lidhur me ankesën 0135/2025:

"Në pretendimet tona, Autoriteti Kontraktues (AK) është treguar i padrejtë në vendimet e tij, duke shpallur fitues një operator ekonomik i cili nuk i ka plotësuar të gjitha kriteret e përcaktuara nga vetë AK. Edhe pas kërkesës sonë për rishqyrtim, ku kemi prezantuar fakte të qarta, AK është përgjigjur duke i quajtur ato si “devijime të vogla”.

Ajo që është më shqetësuese është përgjigjja e AK në pretendimin tonë të katërt. Në kërkesën e tenderit kërkohet një lugë ngarkuese me peshë minimale 4 ton, ndërsa ne kemi faktuar se luga e OE fitues peshon vetëm 0.9 ton. AK përgjigjet se eskavatori i përdorur ka peshë maksimale të ngarkesës së lejuar 5530 kg, që nuk ka lidhje me kërkesën e dosjes, pasi kërkesa është specifikisht për peshën e lugës ngarkuese, jo për peshën e eskavatorit në tërësi. Kjo tregon se AK ka vepruar me qëllim për të shpallur fitues këtë OE dhe po e mbron atë përmes arsyetimeve jashtë logjikës. Ky mendim përforcohet edhe nga mënyra se si janë trajtuar pretendimet tona të tjera, të cilat AK i ka cilësuar si “devijime të vogla” apo “informata të nevojshme”. Ne konsiderojmë se këtu nuk bëhet fjalë për devijime, por për favorizime të qarta.

Pretendimi i parë: Ne kemi paraqitur se OE fitues është shpallur fitues me çmim “jo normalisht të ulët” sipas nenit 41 të LPP-së. AK është përgjigjur se janë vetëm dy oferta të përgjegjshme dhe nuk mund të llogaritet çmimi mesatar. Megjithatë, AK harron se mesatarja mund të llogaritet edhe me dy numra. Sipas nenit 41.3.i, “çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët

se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm”. Në rastin tonë, çmimi i ofertës fituese është 41% më i ulët se mesatarja.

Pretendimi i dytë: Kemi njoftuar AK se OE fitues nuk i mbulon as shpenzimet bazë të prodhimit sipas paramasës, gjë që rrezikon përmbushjen e projektit. Sipas nenit 6 të LPP, autoritetet janë të obliguara të sigurojnë përdorimin më ekonomik të fondeve publike. Ne kemi ofruar një ofertë brenda vlerës së parashikuar prej 35,000 euro dhe në përputhje me qëllimin e prokurimit. AK është përgjegjës se çmimi nuk është i ulët, pa adresuar konkretisht manipulimet e mundshme me çmime.

Pretendimi i tretë: Eskavatori i ofruar tejkalon tonazhin e kërkuar, por AK e ka cilësuar këtë si “devijim të vogël”. Kjo është e papranueshme, veçanërisht kur kërkesat në dosjen e tenderit janë të qarta dhe precize. Për më tepër, oferta e dytë është jo-suksesshme, prandaj një devijim nuk duhet të pranohet për OE fituesin.

Pretendimi i katërt: Kjo pikë tregon më qartë shkëlqen nga AK. Luga e eskavatorit peshon vetëm 0.9 ton, kurse kërkesa është për një lugë ngarkuese prej minimumi 4 ton. Asnjë komision nuk ka të drejtë të ndryshojë kërkesat e dosjes së tenderit bazuar në interpretime të lira. Për më tepër, nëse këtij eskavatori i shtohet një lugë 4 ton, ai do të bëhej i paqëndrueshëm dhe do të rrëzohej menjëherë, duke dëshmuar se kemi të bëjmë me manipulim dhe mashtrim të vetë komisionit.

Pretendimi i pestë: AK konsideron se informacionet janë të mjaftueshme, por injoron mungesën e datave të nënshkrimit dhe përfundimit të kontratave të prezantuara nga OE fitues. Ligji kërkon që kontratat të kenë të gjitha informacionet e plota, përfshirë datat, të cilat janë të domosdoshme për të analizuar përmbushjen e afateve të kontratave.

Pretendimi i gjashtë: AK konstaton se personi ka pesë vite përvojë pune bazuar në CV, por kjo CV nuk ka datë hartimi. Në përmbajtjen e saj shkruhet “aktualisht tani”, por të gjitha aktivitetet e përmendura janë të përfunduara deri në vitin 2021. Sipas referencave të bashkangjitura nga vetë inxhinieri, projektet janë realizuar nga 2017 deri në 2021. Kjo tregon se përvoja nuk është aktuale dhe është e pamjaftueshme për të përmbushur kriterin.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim: *"1. Lidhur me pretendimin tuaj të parë dhe të dytë: Se fitues është shpallur një kompani e cila ka ofruar tender jo-normalisht të ulët, në bazë të nenit 61 të LPP-së dhe nenit 41 të Rregullores Nr. 002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, përkatësisht nenit 41.3, të cilit i jeni referuar edhe ju në kërkesën për rishqyrtim, në të cilin thuhet:*

“Autoritetet kontraktuese do të kërkojnë nga operatorët ekonomikë që të shpjegojnë çmimin e ofruar për tenderët e përgjegjshëm.”

Komisioni i vlerësimit konsideron se ka vepruar drejt në vlerësimin e kësaj oferte, për arsye se në këtë rast kemi pasur vetëm dy operatorë ekonomikë të përgjegjshëm, dhe për këtë arsye nuk është përmbushur kushti i parë, që të ketë tri oferta të përgjegjshme, siç parashihet me rregullore.

2. Lidhur me pretendimin tuaj të tretë, Që ka të bëjë me pajisjen eskavator me çekan, max 6T, dhe pretendimin tuaj se kjo pajisje, së bashku me çekanin, e tejkalon tonazhin e kërkuar sipas kërkesave të AK-së – komisioni i vlerësimit, duke u bazuar në nenin 59.4 të LPP-së dhe nenet 45.19, 45.20 dhe 45.21 të Rregullores Nr. 002/2024, vlerëson se ky është një devijim i vogël.

3. Lidhur me pretendimin tuaj të katërt, Që ka të bëjë me pajisjen lugë ngarkuese minimum 4T, me pretendimin se kjo pajisje nuk e përmbush kërkesën e AK-së për tonazh – komisioni i vlerësimit konsideron se ka vepruar drejt, për arsye se operatori ekonomik, për këtë pajisje, ka ofruar si dëshmi librezën e qarkullimit me numër regjistrimi 01-282-VC dhe me peshë maksimale të ngarkesës së lejuar 5,350 kg, duke përmbushur kështu kërkesën e AK-së.

4. Lidhur me pretendimin tuaj të pestë, Që ka të bëjë me listën e kontratave, dhe pretendimin se kjo listë nuk përmban informacionet e kërkuara nga AK-ja – ky pretendim është i pabazuar, për arsye se komisioni i vlerësimit konsideron se lista e operatorit ekonomik për kontratat i përmban informacionet e nevojshme dhe përmbush kërkesat e dosjes së tenderit.

5. Lidhur me pretendimin tuaj të gjashtë, Që ka të bëjë me inxhinierin (Master apo Bachelor në Ndërtimtari – drejtimi konstruktiv) me përvojë pune minimum 5 vite pas diplomimit, dhe pretendimin tuaj se ky inxhinier nuk i ka 5 vite përvojë pune – ky pretendim është i pabazuar, për arsye se operatori ekonomik e ka përmbushur këtë kërkesë të AK-së, në bazë të të dhënave të paraqitura në CV-në e tij.

Përfundim: Autoriteti Kontraktues konsideron se oferta juaj është vlerësuar me kujdes dhe se gjatë vlerësimit është zbatuar me përpikëri legjislacioni në fuqi për Prokurimin Publik, në përputhje me rregullat dhe udhëzimet e nxjerra nga KRPP.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 25.02.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2025/0135, ndërsa me datë 12.03.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2025/0135 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtrësat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor lidhur me rastin.

Lidhur me pretendimet e OEEng Bau SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0135 ka vlerësuar si në vijim:

Pergjigje ne pretendimin e 1: "Pretendimi i OE ankues në këtë pikë ka të bëjë me tenderët abnormalisht të ulët. OE ankues pretendon se AK, gjatë vlerësimit të ofertave, ka shkelur nenin 41 dhe nuk ka marrë për bazë çmimet, të cilat, sipas OE ankues, e plotësojnë kriterin për t'u klasifikuar si çmime abnormalisht të ulëta. Eksperti shqyrtues sqaron se për këtë aktivitet të prokurimit, konkretisht për LOT 2, kanë ofertuar tre OE.

1. GOE EngBau & Nika pro ing – 30,493.96

2. Euro Raketa – 17,989.08

3. GOE Valdrini & Hidro Trimi – 33,915.56

AK gjate vleresimit ka eliminuar GOE Valdrini shpk & Hidro Trimi keshtuqe kane mbetur dy OE ne gare. Eksperti shqyrtues sqaron se ne baze te RRPP 02/2024 nenin 41.3 Autoritetet kontraktuese do te kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e ofruar për tenderët e përgjegjshëm, kur të përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme: i çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm; ii çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët; iii janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë. Perkunder kalifikimit të tenderit si jonormalisht i ulte ne baze te nenit 41.4 Kur tenderët duken të jenë jo-normalisht të ulët për arsye të tjera nga ato të parashikuara në paragrafin 41.3 të kësaj rregullore, autoritetet kontraktuese mund të vlerësojnë besueshmërinë e tenderëve të tillë dhe rrjedhimisht të kërkojnë shpjegime në përputhje me paragrafët e mëposhtëm dhe nenin 61 të LPP-së.

Eksperti shqyrtues vlerëson se, në bazë të RRPP 001/2022, neni 41.2, nuk është plotësuar kushti që të dorëzohen tre tenderë të përgjegjshëm, rrjedhimisht ofertat nuk janë trajtuar për oferta abnormalisht të ulëta, e që sipas ekspertit shqyrtues, AK në këtë pikë ka vepruar në përputhje me nenin 41.3 të RRPP 002/2024. Prandaj, bazuar në RRPP 001/2022 dhe në dëshmitë e bashkangjitura në e-prokurim, eksperti shqyrtues vlerëson se AK në këtë pikë ka vepruar në përputhje me dispozitat e RPP dhe se pretendimi ankimor nuk është i bazuar.

Përgjigje ne pretendimin e 2: " Pretendimi i OE ankues ka të bëjë me çmimet e ofruara për pozicionet sipas paramasës. OE ankues pretendon se çmimet për pozicionet 1.7, 1.8, 2.3, 2.5, 2.6, 2.9 janë çmime të cilat janë dukshëm nën çmimet e tregut dhe manipulative. Eksperti shqyrtues, pas administrimit të provave të ngarkuara në e-prokurim dhe dëshmime shtesë të ngarkuara nga OE ankues, si dhe hulumtimit të tregut, vlerëson se pozicionet e kontestuara nga OE ankues dhe të dhëna nga OE i rekomanduar për kontratë janë çmime që nuk janë në përputhje me çmimet e tregut dhe se, sipas mendimit të ekspertit shqyrtues, mund të trajtohen sipas nenit 41.4 të RRPP 002/2024: Neni 41.4: Kur tenderët duken të jenë jo-normalisht të ulët për arsye të tjera nga ato të parashikuara në paragrafin 41.3 të kësaj rregulloreje, autoritetet kontraktuese mund të vlerësojnë besueshmërinë e tenderëve të tillë dhe rrjedhimisht të kërkojnë shpjegime në përputhje me paragrafët e mëposhtëm dhe nenin 61 të LPP-së. Rrjedhimisht, eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimor është i bazuar."

Përgjigje në pretendimin e 3: "Pretendimi i OE ankues në këtë pikë ka të bëjë me kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, që sipas FDT është kërkuar: Kërkesa 3. Paisjet teknike b) Eskavator me cekan max 6 T = min 1 copë, Dëshmia 3. Lista e paisjeve e nënshkruar dhe vulosur nga OE, për automjetet që nuk regjistrohen Deklaratat unike doganore apo faturat e blerjes. Për automjetet që regjistrohen Librezat e qarkullimit me validitet. Ne rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë OE duhet të ofroj marrëveshjen për marrjen me qira të pajisjeve me dëshmitë sipas kërkesës me lartë. Marrëveshja duhet të jete në emër të këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të këtij projekti e nënshkruar dhe vulosur nga të dyja palët. Eksperti shqyrtues sqaron se me ofertë, OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar eskavatorin YANMAR VIO57-U, i cili është marrë në shfrytëzim me kontratë për qira. Pësia e eskavatorit, sipas prodhuesit, është 5321 kg. Sipas dëshmime të ngarkuara në e-prokurim, pajisja është e ndarë në dy pjesë, ku si pjesë e ndarë është ofruar edhe çekani, i cili sipas DUD-it doganor ka peshën prej 1230 kg. Sipas dëshmime, pësia e eskavatorit tejkalohet për 551 kg. Në

vendimin e kërkesës për rishqyrtim, AK ka vlerësuar se komisioni i vlerësimit e ka trajtuar si devijim të vogël peshën e tejkaluar megjithatë në raportin e vlerësimit të ngarkuar në eprokurim nuk është evidentuar se komisioni e ka trajtuar mospërputhjen e peshës së eskavatorit. Prandaj, bazuar në dëshmitë e ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, raportin e vlerësimit, vendimin mbi kërkesën për rishqyrtim dhe ofertën e Operatorit Ekonomik të rekomanduar për kontratë, eksperti shqyrtues vlerëson se Autoriteti Kontraktues, gjatë procesit të vlerësimit, nuk ka vepruar në përputhje me nenin 59 të LPP-se, si dhe nuk e ka trajtuar ofertën në përputhje me nenin 45.20. Për rrjedhojë, pretendimi ankimor vlerësohet si pjesërisht i bazuar."

Përgjigje në pretendimin e 4: "Pretendimi i OE ankues në këtë pikë ka të bëjë me kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, që sipas FDT është kërkuar: Kërkesa 3. Paisjet teknike f) Luge ngarkuese min 4 T min 1 copë, Dëshmia 3. Lista e paisjeve e nënshkruar dhe vulosur nga OE, për automjetet që nuk regjistrohen Deklaratat unike doganore apo faturat e blerjes. Për automjetet që regjistrohen Librezat e qarkullimit me validitet. Në rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë OE duhet të ofroj marrëveshjen për marrjen me qira të pajisjeve me dëshmitë sipas kërkesës me lartë. Marrëveshja duhet të jetë në emër të këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të këtij projekti e nënshkruar dhe vulosur nga të dyja palët. Pretendimi ankimor ka të bëjë me peshën e luges ngarkuese. OE ankues pretendon se luga e ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson kërkesën për peshën e kërkuar prej 4 ton. Eksperti shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për kontratë me ofertë ka dorëzuar certifikatën e regjistrimit të automjetit me targa 01-282-VC e cila sipas certifikatës ka peshën 5350 kg OE ankues, në pretendimin e tij, i referohet korpës së lugës ngarkuese, duke u referuar kapacitetit të peshës së korpës në m³, që nuk është e njëjtë me atë që është kërkuar me FDT. Prandaj, duke u bazuar në dëshmitë e ngarkuara në eprokurim, eksperti shqyrtues vlerëson se AK gjatë vlerësimit e ka trajtuar ofertën e OE të rekomanduar për kontratë në përputhje me nenin 7 dhe 59 të LPP-së, dhe se pretendimi ankimor i OE ankues nuk është i bazuar."

Përgjigje në pretendimin e 5: "Pretendimi i OE ankues ka të bëjë me Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale që sipas FDT është kërkuar: Kërkesa 1 Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontratat për projekte të ngjashme në vlerë prej per Llot 2 = 50,000.00 Euro, për (tri) vitet e shkuara, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë. Dëshmia 1. Një listë e kontratave të nënshkruar dhe vulosur nga OE ku do të bëhet përshkrimi me këto informata titullin e kontratës, klientin, datën e fillimit të kontratës, datën e përfundimit të kontratës, vlerën e kontratës, Referencat apo pranimin teknik kopje për kontratat e prezantuara për projekte të ngjashme, Nëse kontrata me referencë është me kompani private të deshmohet me transaksion bankar (dëshmi që është kry pagesa). Referencat apo pranimet teknike duhet të jenë në 3 (tri) vitet e shkuara, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë. OE i rekomanduar për kontratë me oferte ka dorëzuar listën e kontratave të realizuara si me poshtë: Pretendimi i OE ankues është se lista e dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka datën e fillimit dhe datën e përfundimit të kontratës sipas kërkesës se dosjes së tenderit dhe rrjedhimisht nuk është i përgjegjshëm. Eksperti shqyrtues, pas administrimit të provave të ngritura në eprokurim, ofertës së OE të rekomanduar për kontratë, vlerëson se kërkesa për tri vitet e fundit nga data e njoftimit të kontratës (27.09.2024) e përfshin edhe kuartalin e katërt të vitit 2021. Kërkesa e FDT-së ka të bëjë me realizimin e kontratave në këtë periudhë dhe se data e fillimit nuk është ndonjë faktor që mund të ndikojë në vlerësim. Rrjedhimisht, data e përfundimit është faktori kyç që duhet të merret parasysh. Prandaj, duke pasur parasysh se periudha përfshin vitet nga 2022, që do të thotë se mosparaqitja e datës së fillimit nuk përbën ndonjë ndryshim në vlerësimin e kontratave. Për më tepër, të gjitha kontratat e paraqitura nga OE i rekomanduar për kontratë janë të realizuara për AK-në si palë kontraktuese

dhe realizimi i tyre mund të konfirmohen nga AK-ja. Prandaj, eksperti shqyrtues vlerëson se AK në këtë pikë ka vepruar në përputhje me nenin 7 dhe 59 të LPP-së dhe se pretendimi i OE ankues nuk është i bazuar."

Përgjigje në pretendimin e 6:*"Pretendimi i OE ankues ka të bëjë me Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale që sipas FDT është kerkuar:LLot 2Stafin profesional b) Min nje inxhinier master apo bachelor i ndertimtarise drejtimi konstruktiv minimum 5 vite pervoj pune pas diplomimit Deshmia 2. Lista e stafit duhet te dorzohet e nenshkruar dhe e vulosur nga OE. Vendimi me shkrim mbi caktimin e menaxherit per kete projekt i nenshkruar dhe vulosur nga OE, Per stafin profesional te deshmohet me Diplome, CV-ja, licenca dhe certifikata sipas kerkeses. Per te gjith stafin duke perfshire edhe puntoret kerkohen Kontratat e punes ose parakontrata per kete projekt.OE i rekomanduar per kontrate ka dorezuar lkisten e stafit profesional per kerkesen e caktuar stafin me inicalet T.B -Bachelor i Ndertimtarise, drejtimi Konstruktiv i diplomuar ne Korrik 2017.Sipas CV-se Inxhinieri ka filluar punen ne vitin 2018 dhe deklarohet se eshte ende ne vazhdim.Eksperti shqyrtues vlerëson se përvoja e punës është dëshmuar nga CV-ja dhe sipas CV-së inxhinieri e plotëson këtë kërkesë. Pretendimi i OE ankues se i njëjti nuk e ka përvojën e punës të dëshmuar me projekte të realizuara nuk është në përputhje me kërkesat e FDT-së, duke pasur parasysh se nuk është kërkuar që të dëshmohej në bazë të projekteve të realizuara.Prandaj, eksperti shqyrtues vlerëson se AK gjatë vlerësimit të ofertave në këtë pikë ka vepruar në përputhje me nenin 7 dhe 59 të LPP-së dhe se pretendimi ankimor i OE ankues nuk është i bazuar."*

Paneli konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtrësia e palëve dhe veprimet e tyre, përbëjnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP, dhe se nuk ka nevojë të kërkohen nga autoriteti kontraktues dhe/ose parashtrësi i ankesës që të sigurojë informata dhe/ose shpjegime shtesë, në kuptim të paragrafit 3, të nenit 116 të LPP.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues pas vlerësimit dhe administrimit të provave sipas ankesës së dorëzuar sqaron se konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues për këtë lëndë janë pjesërisht të qëndrueshme. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin vetëm konstatimeve lidhur me pretendimin e parë, pretendimin e trete , pretendimin e katert, pretendimit të pestë dhe pretendimit të gjashtë ndërsa nuk i ka falur besimin ekspertit shqyrtues sa i përket konstatimeve për pretendimin e dytë.

Vlen të theksohet fakti se për Panelin Shqyrtues, konstatimet dhe rekomandimet e ekspertëve shqyrtues nuk janë të detyrueshme, por shërbejnë vetëm si një provë në mesin e të gjitha provave tjera që vlerëson në secilën lëndë veç e veç. Paneli Shqyrtues vendos në mënyrë të pavarur, objektive dhe me kujdesin e duhur profesional duke mbrojtur gjithmonë interesin e publikut përmes LPP dhe legjislacionit sekondar në fuqi për prokurimin publik.

Lidhur me pretendimin e dytë ankimor Paneli shqyrtues nuk është pajtuar me konstatimin e ekspertit shqyrtues të cilin eksperti e ka cilësuar si të bazuar sepse në arsyetimin e tij sa i

perkete çmimeve për pozicionet 1.7, 1.8, 2.3, 2.5, 2.6, 2.9 të cilat i ka konsideruar si çmime që nuk janë në përputhje me çmimet e tregut pa e bërë asnjë hulumtim faktik në treg kështu duke e cilësuar kështu pa dhënë asnjë argument ose fakt bindës për Panelin Shqyrtues. Rrjedhimisht PSH e konsideron se pretendimi ankimor është i pabazuar.

Mirëpo përtej këtyre fakteve, vlen të theksohet se autoriteti kontraktues e gëzon autonominë e plotë për të ekzaminuar, krahasuar edhe vlerësuar të gjitha ofertat e pranuar në një aktivitet të prokurimit. Duke qenë se në rastin konkret AK ka vlerësuar dokumentet në mënyrën e elaboruar si më sipër, nuk ekziston bazë e mjaftueshme për të kthyer në rivlerësim aktivitetin e prokurimit vetëm sa i përket këtij fakti. Përndryshe AK e gëzon të drejtën që në rast të nevojës të kërkojë edhe garancione shtesë nga tenderuesi i rekomanduar me rastin e lidhjes së kontratës.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit dhe konsideron se Autoriteti Kontraktues gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave ka vepruar në përputhje me LPP . Në këtë mënyrë konstaton se aprovohet si pjesërisht e bazuar ankesa e OE ankues ndërsa mbetet në fuqi njoftimi mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit Llot 1 Ndërtimi i urës metalike në fshatin Hallaq i Vogël, Llot 2 Rregullimi i kanalizimit në rrugën Aleksandër Stipcevic, Llot 3 Rikonstruimi i ndriçimit publik në Janjevë dhe Gadime e Ulët. me numër të prokurimit 613-24-10149-5-2-1.

Nga ky kënd i vështrimit, Paneli Shqyrtues ka marrë parasysh edhe nenin 104 par. 4 të LPP ku përcaktohet se *“Në ndërmarrjen e masave të përcaktuara OSHP duhet të veprojë në mënyrë proporcionale me shkëlqen e pretenduar ose çështjen për të cilën është paraqitur ankesa, dhe të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik”*. Paneli Shqyrtues ka marrë në konsideratë edhe faktin se ankuesi ka ofertuar me çmim dukshëm më të lartë sesa OE i rekomanduar për kontratë. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues është nisur nga parimi themelor për mbrojtjen e interesit të publikut qoftë në aspektin e parandalimit të vonësive të paarsyeshme ashtu edhe në mbrojtjen e buxhetit publik të AK.

Paneli vlerësues sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: *“Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...”* si dhe në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: *“...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lartë të transparencës dhe të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”*. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP-së, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Paneli Shqyrtues, pas shqyrtimit të gjitha fakteve dhe argumenteve ka arritur në përfundim se AK gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit nuk ka respektuar dispozitat ligjore të LPP-së, kështu që urdhëron AK-në që gjatë rivlerësimit të këtij aktiviteti të prokurimit të ju përmbahet në tërësi dispozitave ligjore të LPP-së.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Kimete Gashi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN**
- **OE - Eng Bau SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: